



PROGRAMI KOMBËTAR I ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSUESVE 2026-2028



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

PROGRAMI KOMBËTAR
I ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSUESVE
2026-2028

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	2
I. HYRJE	3
II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PROGRAMIT.....	5
2.1 Qëllimi i programit.....	5
2.2 Objektivat e programit.....	5
III. PARIMET E PROGRAMIT	7
IV. PËRFITUESIT NGA PROGRAMI.....	8
V. ZBATIMI I PROGRAMIT	12
5.1 Metodologjia e zbatimit të programit.....	12
5.2 Skema e zbatimit të trajnimeve.....	13
5.3 Skema e monitorimit të programit	14
VI. KOMPONENTËT E PROGRAMIT	15
6.1 Komponentët kryesorë të PKZHPM-së 2026-2028	15

I. HYRJE

Në kontekstin e një arsimi gjithnjë e më dinamik, me pritshmëri të larta dhe me përfshirjen e inteligjencës artificiale, roli i mësuesit po pëson një transformim të thellë. Mësuesit nuk janë më vetëm transmetues të njohurive, por udhëheqës të zhvillimit të kompetencave të shekullit XXI – duke nxitur të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, kreativitetin, përdorimin e teknologjisë dhe veçanërisht përdorimin e inteligjencës artificiale në procesin mësimor. Kjo kërkon një angazhim të vazhdueshëm ndaj të mësuarit profesional dhe ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të praktikës mësimore.

Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional të Mësuesve (PKZHPM) 2026–2028 është një përgjigje strategjike ndaj nevojave aktuale të sistemit arsimor, të identifikuara përmes analizave të thelluara të ndryshimeve kurrikulare, të rezultateve të analizës së nevojave të mësuesve dhe të sfidave që lidhen me zbatimin e programeve të rishikuara në të gjitha lëndët. Ky program vendos në qendër rritjen profesionale të mësuesve si mjet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe për forcimin e ndikimit të tyre në rezultatet e të nxënit të çdo nxënësi.

Përveç përmirësimit të njohurive dhe praktikave mësimore ***në fushat kurrikulare***, zhvillimi profesional i mësuesve përfshin me prioritet edhe përdorimin e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale për zhvillimin e praktikave shkollore, komponentët etikë, socialë dhe gjithëpërfshirës të profesionit të mësuesit. Integrimi i ***teknologjisë dhe inteligjencës artificiale*** (IA) në shkollë hap një horizont të ri mundësish për të nxitur suksesin e çdo nxënësi. Ajo nuk vjen për të zëvendësuar mësuesin, por për ta fuqizuar atë, duke i dhënë mjete për të përshtatur mësimin sipas nevojave të ndryshme të nxënësve. Përmes teknologjisë dhe IA, procesi i të nxënit bëhet më personal, më dinamik dhe më i lidhur me botën reale, ku secili nxënës ka mundësinë të përforcojë pikat ku ka vështirësi dhe të zhvillojë më tej talentet e tij. Në të njëjtën kohë, zhvillimi i ***aftësive të buta (soft skills)***, si komunikimi efektiv, menaxhimi i emocioneve, puna në grup, menaxhimi i klasës, ndërtimi i marrëdhënieve pozitive, është jetik për krijimin e një klime të favorshme për të nxënit. Këto aftësi u mundësojnë mësuesve të

ndërtojnë ura bashkëpunimi me nxënësit dhe prindërit, të adresojnë nevojat individuale dhe të përforcojnë motivimin dhe vetëbesimin te nxënësit.

Një shtyllë tjetër themelore e këtij programi është përgatitja e mësuesve për të punuar në mënyrë efektive me ***nxënës me aftësi të kufizuara dhe me diversitet të lartë të nevojave arsimore***. Programi parashikon trajnime të posaçme për mësuesit ndihmës për identifikimin, përshtatjen e metodave dhe krijimin e planeve individuale të mësimi, me qëllim përfshirjen e çdo nxënësi në procesin mësimor. Gjithashtu një target i rëndësishëm janë edhe mësuesit e shkollave speciale që po shndërrohen në qendra burimore. Kjo qasje gjithëpërfshirëse së bashku me punonjësit e shërbimit psiko - social dhe oficerët e sigurisë jo vetëm që përmbush standardet bashkëkohore të arsimit cilësor dhe barazisë, por shërben edhe si themel për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, më të ndjeshme dhe më të përgjegjshme.

PKZHPM është konceptuar si një program gjithëpërfshirës ***për të gjitha moshat duke filluar me mësuesit e rinj (deri në 3 vjet punë) dhe vijon edhe me mësuesit me eksperiencë në arsim***, i cili jo vetëm që përcakton objektivat dhe rezultatet e pritshme të zhvillimit profesional, por gjithashtu siguron koordinimin institucional, përcaktimin e kompetencave që do të zhvillohen, përmbajtjen trajnuese dhe planin konkret të zbatimit dhe monitorimit.

II. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PROGRAMIT

2.1 Qëllimi i programit

Qëllimi i PKZHPM 2026–2028 është përmirësimi i cilësisë së arsimit parauniversitar nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve, duke u fokusuar në përvetësimin e praktikave bashkëkohore të mësimdhënies dhe forcimin e kompetencave profesionale të mësuesve për të ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e arritjeve dhe mirëqenien e nxënësve.

Programi synon të krijojë një kornizë të qëndrueshme dhe të koordinuar për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve, në bashkëpunim me të gjitha institucionet dhe aktorët e përfshirë në fushën e arsimit, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e rezultateve të nxënësve dhe në zhvillimin e një kulture të të nxënit gjatë gjithë jetës.

2.2 Objektivat e programit

- a) *Rritja e cilësisë së arsimit parauniversitar, nëpërmjet zhvillimit të mendimit krijues të nxënësve.* Përmirësimi i kompetencave, krijuese pedagogjike dhe lëndore për të gjithë mësuesit sipas profileve përkatëse në përputhje me përditësimet kurrikulare dhe me kornizat ndërkombëtare të vlerësimit, në funksion të rritjes së standardit arsimor dhe të përmirësimit të rezultateve të të nxënit.
- b) *Përshtatja e praktikës mësimore me përditësimet në kurrikul dhe programet lëndore.* Mbështetja e mësuesve në zbatimin me kompetencë të ndryshimeve të fundit në programet mësimore, përmes orientimit të qartë në rezultatet e të nxënit, zhvillimin e kompetencave dhe qasjeve të integruara ndërkurrikulare.
- c) *Fuqizimi i performancës mësimore të nxënësve.* Zbatimi i metodave mësimore që nxisin mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve, kreativitetin dhe të nxënit e thelluar.
- d) *Nxitja e inovacionit dhe integrimi i teknologjisë në mësimdhënie.* Zhvillimi i aftësive digjitale të mësuesve dhe aftësinë për të integruar mjete teknologjike, elementë të

kodimit dhe IA në orën mësimore, me qëllim krijimin e mjediseve tërheqëse dhe ndërvepruese për nxënësit.

- e) *Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe përditësimi me praktikën bashkëkohore.* Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së strukturuar dhe të personalizuar, mësuesit do të përvetësojnë praktikën më të mirë të mësimdhënies, të të nxënësve dhe të vlerësimit në përputhje me zhvillimet më të fundit në arsim.
- f) *Përfundimi i barazisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim.* Ndërtimi i një qasje gjithëpërfshirëse, që adreson në mënyrë efektive nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara, me nevojë të veçantë arsimore dhe të grupeve të vulnerabël, duke siguruar akses të barabartë në arsim cilësor dhe përmirësim të mirëqenies së tyre psikologjike dhe sociale.
- g) *Zhvillimi i aftësive të buta dhe etikës profesionale të mësuesit.* Nëpërmjet trajnimeve që synojnë përmirësimin e komunikimit ndërmjet personal, ndjeshmërisë sociale, empatisë, menaxhimit të klasës dhe ndërtimit të marrëdhënieve pozitive me nxënësit dhe kolegët, duke ndikuar pozitivisht në klimën shkollore dhe në mirëqenien e përgjithshme të nxënësve.
- h) *Krijimi i një mjedisi të sigurt, mbështetës dhe motivues për të nxënësit.* Nëpërmjet ndërhyrjeve trajnuese që fuqizojnë rolin e mësuesit si udhëheqës i një klase gjithëpërfshirëse dhe emocionalisht të shëndetshme, ku nxënësit ndihen të respektuar, të dëgjuar dhe të mbështetur për të arritur potencialin e tyre të plotë.
- i) *Zbatimi i mekanizmave të matshëm për monitorimin dhe vlerësimin e progresit.* Vendosja e treguesve të qartë të cilësisë për zhvillimin profesional të mësuesve dhe për ndikimin e tij në rezultatet e nxënësve, duke siguruar transparencë, llogaridhënie dhe përmirësim të vazhdueshëm të programit.

III. PARIMET E PROGRAMIT

Zbatimi i Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional 2026–2028 mbështetet në parimet e mëposhtme, të cilat garantojnë një proces të strukturuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të zhvillimit profesional të mësuesve:

- *Përfshirja e detyrueshme, falas dhe gjithëpërfshirëse.* Programi është i detyrueshëm dhe falas për të gjithë mësuesit e sistemit të arsimit parauniversitar që përfshihen në veprimtaritë e planifikuara, duke siguruar një përfshirje të barabartë dhe koherente në të gjithë vendin.
- *Profesionalizmi i mësuesit si themel i ZHVP-së.* Programi mbështetet në konceptin që mësuesit janë profesionistë të pavarur dhe kompetentë, të aftë për të reflektuar dhe për të përmirësuar vazhdimisht praktikën e tyre mësimore.
- *Fokus i qartë në rritjen profesionale dhe zhvillimin e kompetencave.* Veprimtaritë e planifikuara synojnë rritjen profesionale të mësuesve përmes zhvillimit të kompetencave të nevojshme pedagogjike, teknologjike, ndërdisiplinore dhe etike.
- *Përmbajtje dhe burime të strukturuar në mbështetje të të nxënit.*
- *Ndërveprim me zhvillimet bashkëkohore në arsim.* Programi i ekspozon mësuesit ndaj çështjeve aktuale dhe inovative në fushën e arsimit parauniversitar, përfshirë përditësimet në kurrikulat lëndore, mësimin e personalizuar, përdorimin e teknologjisë, qasjet ndërdisiplinore, mësimin gjithëpërfshirës dhe kompetencat për të ardhmen.
- *Bashkëpunim dhe angazhim institucional.* Zbatimi i programit bazohet në bashkëpunimin ndërinstitutional, në ndarjen e qartë të roleve dhe përgjegjësi, në përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara dhe në angazhimin e përbashkët për cilësi dhe efektivitet.
- *Përgjegjshmëri dhe cilësi në çdo hallkë të zbatimit.* Institucionet përgjegjëse do të garantojnë koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të zbatimit të programit, duke siguruar përmirësim të vazhdueshëm dhe ndikim të matshëm në praktikën arsimore.

IV. PËRFITUESIT NGA PROGRAMI

Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2026–2028 i drejtohet shumë aktorëve në sistemin arsimor parauniversitar, duke promovuar përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe ngritjen e standardeve profesionale të mësuesve. Në thelb të programit është ndërtimi i një ekosistemi bashkëpunues dhe të koordinuar të zhvillimit profesional, ku të gjitha palët përfshihen në mënyrë aktive dhe kontribuese.

1. Mësuesit lëndorë të klasave 1-12, (përfshirë edhe mësuesit ndihmës, mësuesit Institucionet e arsimit të lartë e arsimit parashkollor, mësuesit e qendrave burimore etj.)

Grupi kryesor përfitues janë mësuesit e arsimit parauniversitar, ndërsa programi synon forcimin e kompetencave profesionale dhe metodologjike, përditësimin e praktikave mësimore në përputhje me ndryshimet kurrikulare dhe zhvillimet teknologjike, përfshirë inteligjencën artificiale, si dhe rritjen e ndjeshmërisë ndaj arsimit gjithëpërfshirës, etikës profesionale dhe zhvillimit socio-emocional të nxënësve.

2. Drejtuesit e shkollave

Drejtorët dhe nëndrejtorët e përdorin programin për të ndërtuar një kulturë të mësimdhënies reflektuese dhe përmirësimit të vazhdueshëm, për të planifikuar dhe monitoruar zhvillimin profesional të stafit mësimor, si dhe për të mbështetur rritjen e performancës së shkollës në përputhje me standardet e cilësisë.

3. Punonjësit e shërbimit psiko- social dhe oficerët e sigurisë

SHPS dhe OS e përdorin programin për të identifikuar dhe adresuar në mënyrë të hershme nevojat psiko-sociale dhe situatat e riskut të nxënësve, në bashkëpunim me mësuesit dhe drejtuesit e shkollës. Njëkohësisht, programi shërben për planifikimin dhe zbatimin e masave mbështetëse dhe ndërhyrjeve të synuara që promovojnë mirëqenien, sigurinë dhe përfshirjen e të gjithë nxënësve, veçanërisht atyre vulnerabël.

4. Koordinatorët e sigurimit të cilësisë

Koordinatorët e cilësisë janë aktorë kyç në identifikimin dhe analizimin e nevojave për zhvillim profesional në nivel shkolle, si dhe në mbështetjen e ndjekjes dhe reflektimit mbi progresin e mësuesve në raport me programin. Ata monitorojnë përmirësimin e praktikave gjatë orëve mësimore dhe ndikimin e tyre në rezultatet e nxënësve, si pasojë e pjesëmarrjes në program. Njëkohësisht, luajnë rol të rëndësishëm në nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet mësuesve dhe ndarjen e praktikave të mira në nivel shkolle dhe rrjeti.

5. Koordinatorët e orientimit të karrierës së nxënësve

Koordinatorët e orientimit të karrierës së nxënësve janë aktorë kyç në mbështetjen e nxënësve gjatë orientimit profesional dhe planifikimit të karrierës, përmes identifikimit dhe zhvillimit të prirjeve, aftësive dhe interesave individuale. Ata ndërtojnë partneritete me mësuesit, prindërit dhe aktorët lokalë për të lehtësuar tranzicionin nga arsimi drejt arsimit të mëtejshëm ose tregut të punës (AML). Njëkohësisht, promovojnë kulturën e zhvillimit personal dhe profesional, duke i udhëzuar nxënësit drejt zgjedhjeve të informuara për të ardhmen.

6. Mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë

Mësuesit e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë janë përfitues të rëndësishëm të programit, pasi luajnë rol kyç në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare, forcimin e identitetit kombëtar dhe lidhjes me atdheun tek fëmijët e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Programi i mbështet ata në përditësimet kurrikulare dhe metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies, duke rritur efektivitetin dhe tërheqjen e procesit mësimor. Njëkohësisht, ai nxit bashkëpunimin ndërinstitucional dhe shërben si mekanizëm lidhës për zhvillimin e qëndrueshëm të arsimit shqip në diasporë.

7. Trajnerët (ToT) dhe drejtuesit e rrjeteve profesionale

Kjo kategori, që përfshin ToT, trajnerë të akredituar, drejtues të rrjeteve profesionale dhe ekipeve kurrikulare, përfiton nga përditësimi me qasjet më të reja pedagogjike dhe praktikat trajnuese, rritja e kapaciteteve për të dizajnuar dhe zbatuar trajnime me ndikim të matshëm, si dhe forcimi i rolit të tyre si mentorë dhe mbështetës të zhvillimit profesional të kolegëve në shkollë.

8. Institucionet arsimore parauniversitare

Shkollat dhe ekipet e tyre pedagogjike janë përdorues të drejtpërdrejtë të programit për të lehtësuar zbatimin e programeve të reja mësimore, për të siguruar një mësimdhënie cilësore të bazuar në kompetenca dhe për të forcuar bashkëpunimin horizontal ndërmjet mësuesve.

9. Autoritetet arsimore dhe politikëbërësit

Institucionet kombëtare dhe vendore (MA, ASCAP, QSHA, AKAP, DRAP, ZVAP) e përdorin programin për të kuptuar në mënyrë sistemike nevojat për zhvillim profesional, për të mbështetur politikat afatgjata për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe për të monitoruar, përmes indikatorëve, ndikimin e programit në performancën mësimore dhe rezultatet e nxënësve.

10. Ofruesit e trajnimeve dhe IAL-të

Institucionet e arsimit të lartë agjencitë që kanë të akredituara aktivitete për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë e përdorin programin për bashkërendimin e moduleve trajnuese me prioritetet kombëtare, përhapjen e praktikave të bazuara në kërkim dhe përvojë shkencore, si dhe ofrimin e formave fleksibël të zhvillimit profesional në përputhje me kërkesat e mësuesve.

11. Partnerët strategjikë

Organizatat ndërkombëtare, OJF-të dhe partnerët zhvillimorë kontribuojnë në program përmes ofrimit të ekspertizës tematike, burimeve mësimore dhe mbështetjes financiare,

promovimit të inovacionit dhe teknologjisë në zhvillimin profesional, si dhe ndihmës për shtrirjen e programit në komunitetet më të marginalizuara.

12. Ekspertët arsimorë dhe studiuesit

Ekspertët, studiuesit dhe autorët e moduleve e përdorin programin për të ndarë gjetje shkencore dhe qasje inovative pedagogjike, për të ndërtuar trajnime të bazuara në evidencë dhe ndikim të matshëm, si dhe për të mbështetur hartimin e standardeve të reja të praktikës mësimore.

13. Ekipet e inspektimit dhe monitorimit

Inspektorët dhe vlerësuesit institucional ndjekin zbatimin e trajnimeve në nivel shkolle dhe kombëtar, vlerësojnë ndikimin e tyre në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe japin rekomandime për përmirësim të mëtejshëm të programeve dhe strategjive të zhvillimit profesional.

14. Nxënësit dhe prindërit

Nxënësit dhe prindërit, ndonëse nuk janë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në trajnim, janë përfituesit përfundimtarë të programit përmes përmirësimit të cilësisë dhe gjithëpërfshirjes së mësimdhënies. Programi kontribuon në rritjen e mirëqenies në klasë, përqendrimin në nevojat individuale të nxënësve dhe forcimin e partneritetit shkollë–familje, të bazuar në komunikim të hapur dhe profesional.

Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2026–2028 funksionon si një platformë bashkëpunimi ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në sistemin arsimor. Ai nxit ndarjen e njohurive, inovacionit dhe burimeve për të garantuar një zhvillim profesional me ndikim real në praktikë dhe për të përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme cilësinë e arsimit në vend.

V. ZBATIMI I PROGRAMIT

5.1 Metodologjia e zbatimit të programit

Zbatimi i **Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve 2026–2028** është një proces kompleks, i ndër institucionalizuar dhe i bazuar në evidenca, që kërkon koordinim të mirë strukturuar, angazhim të palëve të interesuara dhe përshtatje të vazhdueshme me kontekstin arsimor dhe zhvillimet e kohës.

Metodologjia përfshin elementët e mëposhtëm:


- a) **Identifikimi i përfituesve të synuar.** Në bashkëpunim me AKAP, DRAP-et dhe ZVAP-et, për secilin komponent përcaktohen qartë grupet e përfituesve.
- b) **Përcaktimi i rezultateve të pritshme.** Për çdo komponent janë formuluar rezultate të pritshme.
- c) **Angazhimi i palëve të interesuara.** Identifikohen aktorët kryesorë institucionalë dhe partnerët potencialë. Përcaktohen mekanizmat e bashkëpunimit dhe ndarjes së përgjegjësisë për hartimin, zbatimin dhe mbështetjen e trajnimeve.
- d) **Zhvillimi i përmbajtjes së përgjithshme trajnuese.** Hartohet përmbajtja e përgjithshme për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë në përputhje me standardet profesionale të mësuesit dhe kompetencat që synohen.
- e) **Zbatimi i komponentit.** Për çdo komponent do të zhvillohet kalendari i zbatimit që garanton përfshirje të gjerë gjeografike dhe tematike, përdorim të formateve fleksibël dhe mbështetje teknike dhe administrative gjatë gjithë procesit.
- f) **Sigurimi i cilësisë.** Cilësia e zbatimit monitorohet përmes vlerësimeve të pjesëmarrësve pas çdo trajnimi, analizës së përmbushjes së objektivave të komponentit dhe kontrollit të standardeve të zbatimit në çdo hallkë të procesit.
- g) **Komunikimi dhe promovimi.** Zhvillohet një strategji komunikimi dhe ndërgjegjësimi për të informuar dhe angazhuar mësuesit dhe institucionet arsimore për përfshirjen në trajnimet e programit.

- h) **Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit.** Për secilin komponent planifikohen monitorime të brendshme të ecurisë, vlerësime të ndikimit të trajnimeve në praktikën mësimore dhe analiza të të dhënave dhe rekomandime për përmirësim afatshkurtër dhe afatgjatë.
- i) **Fleksibiliteti dhe përmirësimi i vazhdueshëm.** Në çdo fazë të zbatimit sigurohet fleksibilitet për të përshtatur përmbajtjen, metodën apo kohëzgjatjen e trajnimeve në funksion të kontekstit arsimor, reagimeve nga përfutuesit dhe dinamikës së nevojave profesionale të mësuesve.


Programi mund të përditësohet për çdo vit të zbatimit të tij, në varësi të nevojave dhe interesave të mësuesve, si dhe në varësi të prioriteteve të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Kjo qasje metodologjike synon të garantojë që programi të jetë *efektiv, i zbatueshëm dhe me ndikim të qëndrueshëm*, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së arsimit në Shqipëri.

5.2 Skema e zbatimit të trajnimeve



5.3 Skema e monitorimit të programit



VI. KOMPONENTËT E PROGRAMIT

6.1 Komponentët kryesorë të PKZHPM-së 2026-2028

Programi përfshin komponentë të ndërlidhur, të cilët synojnë mbështetjen e mësuesve dhe punonjësve të tjerë të arsimit në përputhje me ndryshimet kurrikulare, nevojat profesionale dhe prioritetet strategjike të sistemit arsimor. Secili komponent përmban përfituesit dhe numrin e tyre, synimet e komponentit, përmbajtjen (njohuri, aftësi qëndrime).

Nr.	Komponenti	Përfituesit për çdo vit	Materiale të përgatitura	Kredite për çdo pjesëmarrës
1	Zhvillimi profesional i të gjithë mësuesve për përditësimet kurrikulare sipas profileve mësimore dhe për përdorimin e IA në praktikën shkollore.	17,000	14 module për çdo lëndë	8 kredite
2	Zhvillimi profesional i drejtuesve të rrjeteve profesionale dhe/ose koordinatorëve të sigurimit të cilësisë për aftësitë e buta, etikën profesionale dhe zhvillimin e aftësive për analizën profesionale të praktikave të mësimdhënies.	1,100 + 300	1 +1+1 module	12 kredite
3	Zhvillimi profesional i shërbimit psiko-social, oficerëve të sigurisë, i mësuesve ndihmës për përfshirjen e grupeve vulnerabël në shkollë, si dhe i mësuesve të institucioneve të arsimit special në lidhje me funksionimin e qendrave burimore sipas VKM-së përkatëse.	750 punonjës të SHPS + 130 OS + 2,000 mësues ndihmës + 100 mësues të qendrave burimore	1+ 1 + 1 module	4 kredite

4	Zhvillimi profesional i koordinatorëve të orientimit për karrierë të nxënësve lidhur me zhvillimin e veprimtarive.	300	1 modul	4 kredite
5	Zhvillimi profesional i mësuesve dhe drejtuesve të shkollave me SmartLab në teknologji, aftësi digjitale dhe inteligjencë artificiale.	50 punonjës ZVAP 200 drejtues 800 mësues AF 200 mësues TIK	4 module	4 kredite
6	Zhvillimi profesional i mësuesve të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë	200	1 modul	4 kredite
7	Zhvillimi profesional i mësuesve të arsimit parashkollor në lidhje me zhvillimin holistik të fëmijëve 3-6 vjeç sipas fushave të zhvillimit.	2000 mësues të APSH	1 modul	4 kredite
8	Fuqizimi i kompetencës së komunikimit në gjuhën angleze në nivel teknik për mësuesit e arsimit fillor në shkollat me SmartLab.	300 Mësues të AF	1 mikrokredencial	30 kredite
	Total	25,430 përfitues	28 module trajnimi/ mikrokredenciale	



Rruga "Naim Frashëri"

Nr. 37

Tiranë

Shqipëri

www.ascap.edu.al

sekretaria@ascap.edu.al

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**